



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 26/1 Prot.

Tiranë, më 15/6 /2011

Lënda: Rekomandim për **“WESTERN ATLAS INTERNATIONAL, Inc.**

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **“WESTERN ATLAS INTERNATIONAL, Inc,**

KONSTATOVA

Më datë 23.05.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit **“WESTERN ATLAS INTERNATIONAL, Inc,** me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave për punonjësit të parashikuara në nenet 5,6,7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, parashikuar në nenet 8,9 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” .

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi, “WESTERN ATLAS INTERNATIONAL, Inc. sh.p.k. në ushtrim të aktivitetit të tij, për punonjësit e tij (një grup prej 5-punonjës), respekton rregullat e përcaktuara në politikat e grupit “Baker Hughes” duke mbledhur të dhëna personale për punonjësit përmes formularit tip “Baker Huges formular personel”, të dhëna si, emri, mbiemri, vendlindja, datëlindja, shtetësia, gjinia, gjendja civile, adresa, kodi postar, telefon, nr. i sigurimeve shoqërore.

Ky kontrollues, të dhënat personale për punonjësit e vet i transferon në qendrën e grupit “Baker Hughes” për Europën në Perugia Itali, duke u bërë kështu pjesë e databazës së punonjësve të grupit.

Kontrolluesi, “WESTERN ATLAS INTERNATIONAL, Inc. sh.p.k, ka plotësuar detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke zbatuar nenin 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Në këtë njoftim i cili është plotësuar nga studio ligjore “Kalo & Associates”, si përfaqësues ligjor i grupit “Baker Hughes” në Shqipëri është deklaruar aktiviteti i grupit “Baker Hughes” lidhur me të dhënat personale në të gjitha rubrikat që përmban formulari i njoftimit dhe jo aktiviteti i kontrolluesit “Western Atlas International, Inc” sh.p.k, me veprimtari në territorin Shqiptar.

Kontrolluesi “Western Atlas International, Inc” si përfaqësues i grupit “Baker Hughes” në Shqipëri në zbatim të nenit 4 pika 3 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” duhet të plotësojë formularin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si kontrollues më vete, duke ju referuar aktivitetit që ai kryen në Shqipëri.

Sa më sipër, kontrolluesi “Western Atlas International, Inc” ka plotësuar në mënyrë të gabuar formularin e njoftimit pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale , pasi e ka plotësuar atë për grupin “Baker Hughes” dhe jo për aktivitetin e tij si kontrollues më vete.

Ky kontrollues duhet të respektojë nenin 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” sipas së cilës ai detyrohet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.

Kontrolluesi “Western Atlas International, Inc”, pranoi faktin e gabimit në plotësimin e njoftimit dhe nuk paraqiti asnjë pretendim lidhur me konstatimet e bëra nga grupi i kontrollit administrativ.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “WESTERN ATLAS INTERNATIONAL, Inc. sh.p.k. duhet të përmbushë detyrimin lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke ju referuar aktivitetit të “*Western Atlas International, Inc*” Fier.

Kryerja e këtij rekomandimi të rëndësishëm për mbrojtjen e të dhënave personale, që ju ngarkon ligji, të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

